

VENDIM
Nr. 602, datë 31.8.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 23, DATË 20.1.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2016 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “... 2 207 veta ...”.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, në ndarjen “Gr.28 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, shtohet nëndarja sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 2, të vendimit, pas fjalëve “... Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave,...” shtohen fjalët “...dhe punonjësit e shërbimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve...”.

4. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	11			
	<i>Gjykata e Rrethit Durrës</i>	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	<i>Gjykata e Rrethit Lezhë</i>	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	<i>Gjykata e Rrethit Sarandë</i>	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	<i>Gjykata e Rrethit Tropojë</i>	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	<i>Gjykata e Apelit Tiranë</i>	2	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	<i>Gjykata e Apelit Durrës</i>	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	<i>Gjykata e Apelit Vlorë</i>	1	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj
	<i>Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë</i>	3	Sekretar gjyqësor	8 orë / ditë	4 muaj